



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
Regulatorna Komisija Javne Nabavke
Public Procurement Regulatory Commission



Manual përdorimi

për

Operatorë Ekonomik

Vlerësimi i Performancës së Kontraktorëve

maj, 2020



Përmbajtja

1. Hyrje	3
2. Informatat e përgjithshme për Modulin CPE	4
3. Operatori Ekonomik	5



1. Hyrje

Moduli për vlerësimin e përformancës së kontraktorëve (eng. Contractor Performance Evaluation - CPE) është i zhvilluar në platformën ueb dhe për qëllim kryesor ka vlerësimin e përformancës së kontraktorëve për kontratat e realizuara dhe ato që janë në realizim.

Moduli është i integruar në sistemin e-Prokurimi dhe është i qasshëm nga ky sistem.

Qasja në këtë modul është e mundshme vetëm për shfrytëzuesit që kanë të drejta përdorimi në këtë modul. Të drejtat e qasjes në CPE caktohen nga administratorët e sistemit të e-Prokurimit.

Vlerësimi i përformancës së një kontrate realizohet në disa faza:

1. Vlerësimin fillestar të përformancës së një kontrate e realizon menaxheri i asaj kontrate nga AK.
2. Rishikimi i vlerësimit realizohet nga zyrtari i prokurimit të AK, apo ndonjë zyrtarë tjetër
3. Njoftimi i OE mbi vlerësimin e kontratës realizohet nga zyrtari në pikën 2
4. OE e ka mundësinë që ta apeloj këtë vlerësim në afat kohor të paracaktuar (p.sh. prej 40 ditë pas pranimit të vlerësimit), apo ta pranoj vlerësimin. Nëse OE nuk reagon në afatin e paracaktuar, atëherë sistemi automatikisht e dërgon këtë vlerësim si të aprovuar.

Vlerësimi i përformancës së kontraktorëve sipas kontratave realizohet sipas kriterëve vijuese:

- Kontratat të cilat e kanë afatin e implementimit më të shkurtë se një vit kalendarik, do të vlerësohen kur ato të përfundohen
- Kontratat të cilat ndërpriten, vlerësohen me rastin e ndërprerjes
- Kontratat të cilat realizohen para afatit, gjithashtu vlerësohen në momentin e përfundimit të kontratës.
- Kontratat të cilat e kanë afatin e implementimit më të gjatë se një vit kalendarik, do të vlerësohen çdo 365 ditë. Pra një kontratë mund të vlerësohet më shumë se një herë nëse afati i realizimit është më shumë se një vit.

OE në llogarinë e tij në këtë sistem do të paraqiten të gjitha vlerësimet e kontratave të vlerësuara, si pjesëmarrës individual në kontratë apo si grup i operatorëve ekonomik.

Në rastin e grupit të operatorëve ekonomik për një kontratë, të drejtë apelimi për vlerësimin e përformancës ka udhëheqësi i grupit të operatorëve ekonomik. Në këtë rast, vlerësimi i përformancës është i njëjtë për të gjithë anëtarët e grupit ekonomik.



AK do të kenë mundësinë që të shohin vlerësimet e performancave të kontratave për OE të cilët kanë aplikuar në një procedurë tenderike, në këtë mënyrë mund të shohin performancat bë punët e ngjashme.

Në këtë pjesë të dokumentit do të paraqiten vetëm aktivitetet që kanë të bëjnë me zyrtarët e Operatorëve ekonomik. Pjesët që janë të ndërlidhura me aktivitetet që duhet ti realizojnë Administratorët e sistemit të e-Prokurimit dhe stafi i Autoriteti Kontraktues, janë paraqitur në dokumente tjera.

Në vijim janë shpjeguar pjesët kryesore të modulit për pjesën e operatorëve ekonomik dhe mënyrën e përdorimit të tij. Aktivitete e paraqitura në vijim mund ti realizojnë shfrytëzuesit me të drejta të caktuara që iu takojnë operatorëve ekonomik në kuadër të sistemit të e-Prokurimit.

2. Informatat e përgjithshme për Modulin CPE

Moduli është i ndërtuar në 3 gjuhët zyrtare:

- Shqip
- Anglisht
- Serbisht

Në foton më poshtë është paraqitur një tabelë, ku bëhet përshkrimi i disa butonave të cilët përdoren shpesh në modul.







Butonat	Përshkrimi
	Përmes këtij butoni hapet forma ku shtohen të dhëna të reja ne sistem
	Pasi të plotësohen të dhënat e formës së re, përmes këtij butoni të dhënat shtohen në sistem
	Përmes këtij butoni hapet forma për modifikimin e të dhënave ekzistuese të aplikacionit
	Ky buton shërben për ti ruajtur të dhënat që dëshirojmë ti ndryshojmë
	Përmes këtij butoni kemi mundësi ti fshijmë të dhënat nga sistemi
	Përmes këtyre butonave mundësohet eksportimi i listave në formatin PDF dhe Excel, respektivisht.

Figura 1: Sqarimet për butonat kryesor të aplikacionit



3. Operatori Ekonomik

Shfrytëzuesit nga Operatori ekonomik mund ti shohin të gjitha kontratat e vlerësuara që i takojnë atij operatori. Më poshtë është paraqitur lista që është e ngjashme me listën e kontratave tek vlerësimi .

	Numri i Kontrates	Emërtimi i kontratës	Autoriteti kontraktues	Tipi i kontrates	Pala kontraktuese	Nr. Prokurimit	Vlera €	Data e fillimit	Data e Përfundimit	Perf. Indikator	Ditët	Statusi
Proceso	bc123456-18-76-1-2-1/C40	postupak za ponistit 15.03.2018	Contracting Authority	Ugovor s narudžbenicama	Economic Operator	bc123456-18-76-1-2-1	55.000,00			72.00%	3	Prano
Proceso	bc123456-16-672-1-4-7/C41	minimal 22-12-2016	Contracting Authority	Ugovor s narudžbenicama	Economic Operator	bc123456-16-672-1-4-7	450,00			55.00%	0	Approva

Figura 2: Lista e vlerësimeve të performancës të Operatorit Ekonomik


Operatori ekonomik ka mundësi ta shoh një tabelë me disa statistika për performancat e kaluara të tij duke klikuar në butonin **Përformancat e kaluara të Operatorit Ekonomik** dhe hapet forma si në foton e mëposhtme

Operatori Ekonomik :	OE BPN :	Nota e Performancës së kaluar:
Economic Operator		
Nr i kontratave aktive në vlerësim :	Kontrata me vlerën më të ulët :	Kontrata me vlerën më të lartë :
2	0,00	0,00
Nr. i kontratave të vlerësuara :	Rezultati më i ulët :	Rezultati më e lartë :
0		


Figura 3: Performancat e kaluara të Operatorit Ekonomik


Këtu shfaqen disa statistika si : Nota e performances së kaluar, Kontrata me vlerën më të ulët, Kontrata me vlerën më të lartë, Rezultati më i ulët, Rezultati më i lartë, etj.



Përmes butonit  mund ti shohim detajet e vlerësimit

Përmes butonit  mund të shohim procesin e punës të një vlerësimi të kontratës

Nëse OE dëshiron ta proceson vlerësimin e kontratës të bërë nga AK, atëherë duhet shtypur butonin  dhe hapet forma që është pothuajse e njëjtë me procesimin tek forma e vlerësimit nga ana e AK.




The screenshot shows a web form for evaluation. At the top right is a close button (X). Below it, there are two main sections: 'Data e Procesimit' with a date input field containing '27/12/2019' and a calendar icon, and 'Formatet e lejuara : .docx .pdf .doc .png .jpg .jpeg'. To the right of the date field is a file upload section with a document icon, the text 'Zgjedh Dokumentin', and a 'Browse' button. Below these is a large text area labeled 'Përshkrimi'. At the bottom left is a red button with a left arrow and the text 'Ankesë', and at the bottom right is a green button with a right arrow and the text 'Pranoj'.

Figura 4: Procesimi (Aprovimi) i një vlerësimi të kontratës nga ana e OE

Në rastin tonë operatori ekonomik ka 2 mundësi

- Të mos e pranoj rezultatin e vlerësimit të AK dhe të dërgon ankesë te AK duke shtypur butonin



- Ta pranoj rezultatin e vlerësimit të AK duke shtypur butonin , me ç 'rast vlerësimi publikohet automatikisht.

Në rast se Operatori ekonomik nuk përgjigjet në afat prej 40 ditësh vlerësimi i kontratës automatikisht bartet në statusin "I pranuar" dhe publikohet në listën e vlerësimeve të kryera.